



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DELVINË
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Delvinë, më ____ . ____ . 2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje produkte ushqimore dhe të ngjashme me to, për nevojat e Kopshtit me Drekë, Çerdhes dhe Qendrës Ditore për Moshat e Treta”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Drithëra, patate, perime, fruta dhe arra 03200000–3

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,791,438 (katërmilionë e shtatëqindë e nëntëdhjetë e një mijë e katërqindë e tridhjetë e tetë) Lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Delvinë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP-së, nenit 26, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Sipas Kriteve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika 1 e Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, nenit 40, pika 5, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesi vërtetim xhiroje vjetore të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (përkatësisht vitet 2023, 2024 dhe 2025), ku vlera e xhiros minimale vjetore për periudhën e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur edhe në qoftë se operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar më lart nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e limit të kësaj kontrate, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP-së, si dhe nenin 55, pika 4 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi kopje të certifikuara të balanceve vjetore, të konfirmuara prej Administratës Tatimore, përkatësisht për tre vitet e fundit financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku bilanci nuk duhet të ketë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kjo kërkesë për kualifikim konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilancet e njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Dëshmi për furnizime të ngjashme të mëparshme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, për të cilën konkuron operatori ekonomik, që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës si më poshtë:

- a. Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një Ent publik, kontrata furnizimi dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore. **(ose)**

- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë në emër të tij Licencën me kodin II.1.A.1 "Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz"

Në rastet kur operatorët ekonomikë, nuk kanë detyrim ligjor të licencohen nga Qendra Kombëtare e Biznesit me këtë licencë, duhet ata duhet të paraqesin e Ekstraktin Tregtar të subjektit, ku në fushën e veprimtarisë së tij të jetë i përfshirë edhe objekti që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim Nr. 10181 Prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

2.3.3 Operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë.

Për këtë subjekti ofertues duhet të paraqesi certifikatën e mëposhtme:

- Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme), lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim Nr. 10181 Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Kriteri për Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, është vendosur në bazë të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij

kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion certifikimet e duhura për mallrat objekt prokurimi

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetëdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrim të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU-së ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të Dokumentave Standarte të Tenderit (DST).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

2.3.5 Në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues i produkteve si bukë, vezë, qumësht dhe nënprodukte të tij, mish dhe nënprodukte të tij, duhet të paraqesë kontratë/marrëveshje noteriale furnizimi për këto produkte me subjekte të ndryshëm që kryejnë aktivitetin në këto fusha.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në Rekomandim Nr.10181Prot, datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

2.3.6 Subjekti ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qera, nëpërmjet aktit të pronësisë ose kontratës noteriale të qerasë, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës, 1 (një) automjet transporti të përshtatshëm për transportin e produkteve ushqimore ATP (frigorifer), të shoqëruar me Leje qarkullimi, Policë sigurimi, Certifikatë e kontrollit teknik të mjetit, Fotot përkatëse ku të dallohet qartë targa e mjetit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të Dokumentave Standarte të Tenderit (DST).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion

mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Është vendosur ky kriter pasi është në përputhje me objekin e prokurimit dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët datë 19.11.2018 të Agjencisë së Prokurimeve Publike dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit pasi gjykohet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës duke u nisur nga lloji i artikujve që do të transportohen.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë (Me anë të një **“Deklarate”**), që merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi në vendin e dorëzimit të kontratës (Magazina e Bashkisë Delvinë), brenda afatit të përcaktuar në Dokumentave Standarte të Tenderit për lëvrimin e mallit.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor në formulimin e këtij kriteri kërkon prej Operatorit Ekonomik (Përfaqësuesit të subjektit) një deklaratë me anë të së cilës deklaron se merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi deri në vendin e ekzekutimit të kontratës (magazina e Bashkisë Delvinë), pa përfshirë kosto shtesë për këtë shërbim.

II. Argumentimi i Specifikimeve Teknike

Për Specifikimet Teknike të mallrave objekt prokurimi Autoriteti Kontraktor Bashkia Delvinë iu referua Katalogut “Blerje artikuj ushqimorë” i përditësuar datë 20.05.2026 të publikuar në rubrikën “Njoftime 2026”.

SHËNIM:

Krahas standarteve të përcaktuara në “Specifikimet Teknike”, AK do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standartit SSH/EN (ekuivalent me standartet e përcaktuara nga AK), mbi konformitetin e standartit europian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Formulari i Specifikimet Teknike gjenden në (Shtojcën 6) pjesë përbërëse e DST.

Komisioni unanimisht bëri miratimin e këtyre kriterëve për kualifikim dhe vendosi vazhdimin e mëtejshëm i procedurave në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

NJËSIA E PROKURIMIT

1. _____

(Emri, Mbiemri, Firma)

2. _____

(Emri, Mbiemri, Firma)

3. _____

(Emri, Mbiemri, Firma)